

## Syllabusi për kursin: E DREJTA E MJEDISIT

Informata bazike për kursin:	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës
<b>Titulli i kursit:</b>	E Drejta e Mjedisit
<b>Niveli:</b>	Studimet themelore (Bachelor)
<b>Statusi i kursit:</b>	Zgjedhor
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti i tretë (3-të)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 orë
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5 ECTS
<b>Koha / Vendi:</b>	Sipas orarit, F.J.
<b>Mësimdhënësi i kursit:</b>	<b>Vigan QORROLLI, LLM., PhD (c) @UniGraz</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	E-mail: vigan.qorrolli@uni-pr.edu Mob.: +383.44.130.066
<b>Orari i konsultimeve/ vendi:</b>	E martë dhe e mërkurë: 12:00-13:00, Fakulteti Juridik, zyra nr. 42, kati VIII – si dhe në çdo kohë (nga e hëna deri të premten) përmes adresës elektronike.
Përshkrimi i lëndës:	
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë një studim të procesit përmes të cilit operon e drejta përtej kufijve kombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Me fjalë të tjera, kjo lëndë i njofton studentët me të Drejtën e Mjedisit, sikurse në rrafshin kombëtar, poashtu edhe në atë ndërkombëtar, duke shqyrtuar rolin dhe rëndësinë e përdorimit të së drejtës në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të energjisë brenda sferës së mjedisit, tokës, ujit, ajrit, atmosferës dhe specieve.</p> <p>Pjesa e <i>parë</i> e lëndës fillon me një paraqitje të sistemit ligjor ndërkombëtar në kontekst të mbrojtjes mjedisore si dhe të drejtën ndërkombëtare të zbatueshme për aktivitetet e kësaj lëmie. Më saktësisht, diskutohet për historinë, zhvillimin, burimet dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare të mjedisit, si dhe për rolin e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, ndërqeveritare dhe joqeveritare, në zhvillimin e politikave dhe të drejtës së mjedisit, si dhe përfundimisht, në mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>Pjesa e <i>dytë</i>, ndërkaq, trajton çështje bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare të mjedisit dhe të energjisë, duke ndjekur një qasje tematike ndaj problemeve mjedisore dhe energjetike duke përfshirë kërkime të pavarura ligjore nga ana e studentëve për çështje mjedisore brenda kornizës së të drejtës ndërkombëtare. Temat mund të përfshijnë aspekte që lidhen me energjinë bërthamore, të drejtën për zhvillim, mjedisin dhe tregtinë ndërkombëtare, ndryshimet klimatike, dhe të ngjashme.</p> <p>Pjesa e <i>tretë</i> dhe e <i>katërt</i>, ndërkaq, do të shqyrtojë se si e drejta ndërkombëtare publike merret me sektorët e veçantë të energjisë, veçanërisht me naftën dhe gazin,</p>

	dhe sektorët e rinovueshëm, duke përfshirë aktivitetet energjetike në det, si dhe me rolin që energjia luan në të drejtat e njeriut dhe mjedis.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• T'i prezantojë bazat dhe konceptet themelore të rregullimit ligjor ndërkombëtar në fushën e mjedisit; dhe,</li> <li>• T'i analizojë legjislacionet kombëtare, ndërkombëtare dhe evropiane në mënyrë komparative në fushën e mjedisit, sikurse edhe atë të energjisë.</li> </ul>		
<b>Rezultatet e pritura të mësimit:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohin karakterin dhe/ose natyrën ligjore të së Drejtës së Mjedisit, përfshirë burimet e kësaj të drejte;</li> <li>• Njohin, kuptojnë dhe shpjegojnë mënyrën e funksionimit të sistemit ligjor botëror për mbrojtjen e mjedisit dhe lojtarët kryesorë: Shtetet, organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe jo-qeveritare;</li> <li>• Njohin, kuptojnë dhe shpjegojnë parimet kryesore të së Drejtës së Mjedisit, përfshirë tematikat e specializuara siç është mjedisi dhe zhvillimi njerëzor apo mbrojtja e mjedisit dhe tregtia ndërkombëtare;</li> <li>• Disponojnë me kapacitet për analizë dhe mendim kritik lidhur me çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të energjisë.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime praktike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin/konsultimet	2	15	30
Ushtrimet në terren	2	1	2
Kollokviumet, seminarët	2	2	4
Detyrat e shtëpisë	1	6	6
Koha e studimit vetanë të studentit (bibliotekë ose shtëpi)	4	15	60
Përgatitja finale për provim			
Koha për vlerësim të studentit (testet, kuizet, provimi final)			
Projektet, prezentimet, etj.	2	2	4
<b>Gjithsej</b>			<b>136</b>
<b>Metodologjia e mësimit:</b>	Metodologjia e mësimit që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt përfshirjes së studentëve në diskutime. Rëndësi të veçantë i jepet aspekteve praktike të elaborimit të temave konkrete, ku studentët do të angazhohen në detyra praktike që lidhen me temat relevante. Prezentimet e		

	<p>mësimdhënësit do të shërbejnë si pikë fillestare dhe formulim i sistemit brenda të cilit do të orientohet puna e studentëve. Të gjitha materialet e kursit do të publikohen në platformën CourseSites.</p>							
<b>Metodologia e vlerësimit:</b>	<p style="text-align: center;"><b><u>Standardet dhe praktikat e notimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Detyrat</b> <span style="float: right;"><b>15%</b></span></li> <li>• <b>Kuizet</b> <span style="float: right;"><b>10%</b></span></li> <li>• <b>Provimi gjysmë-semesteral</b> <span style="float: right;"><b>25%</b></span></li> <li>• <b>Provimi përfundimtar</b> <span style="float: right;"><b>25%</b></span></li> <li>• <b>Seminari</b> <span style="float: right;"><b>20%</b></span></li> </ul> <p style="margin-left: 40px;"><i>Originaliteti</i> <span style="float: right;">35 %</span></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>Saktësia teknike</i> <span style="float: right;">30%</span></p> <p style="margin-left: 40px;"><i>Kualiteti i prezantimit</i> <span style="float: right;">35%</span></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vijueshmëria</b> <span style="float: right;"><b>5%</b></span></li> </ul> <p><b>Detyrat (Detyrat e shtëpisë)</b> (15% e notës së kursit). Gjatë katërmbëdhjetë javëve të semestrit do të jepen katër (4) detyra të shtëpisë. Orari i detyrave është paraqitur në këtë syllabus. Detyrat e shtëpisë duhet të kthehen në mënyrë elektronike përmes faqes së internetit <i>coursesites</i> <b>deri në fillimin e orës</b> në ditën që është caktuar ose do të konsiderohet vonë.</p> <p><b>Kuizet</b> (10% e notës së kursit). Kuizet do të jenë të shkurtra (10 minuta) dhe me zgjedhje të shumëfishta. Kuizet jepen për të siguruar që studentët kanë kuptuar konceptet themelore të mësuara gjatë 2 - 3 orëve të fundit. Kuizet janë me libra të mbyllura, shënime të mbyllura.</p> <p><b>Provimi mes-semesteral dhe provimi përfundimtar</b> (50% e notës së kursit). Do të ketë një provim mes-semesteral dhe një provim përfundimtar, që do të mbulojnë të gjithë materialin. Provimet do të përbëhen nga përgjigje të shkurtëra (disa fjali) dhe llogaritje të shkurtra. Materiali i provimit do të bazohet në tekstet dhe materialet e paraqitura në ligjërata.</p> <p><b>Seminari dhe Prezantimi në klasë</b> (20% e notës së kursit). Juve do të ju caktohet një seminar gjatë katër javëve të fundit të kursit ku do t'ju kërkohet të bëni hulumtime në temën në lidhje me materialin e kursit. Tema e secilit seminar duhet të miratohet nga studenti dhe instruktori. Pasi të jetë rënë dakord për një temë, studenti duhet të mbledhë informacione, të përmbledhë temën dhe të shkruajë një seminar (5-10 faqe, me zhvendosje të dyfishtë, me font 12 pikësh). Përveç kësaj, një prezantim 10-15 minutësh do të bëhet në klasë, i cili do të përbëhet nga një përmbledhje 10-12 minutëshe e informacionit të projektit dhe 3 minuta për pyetjet.</p> <p><b>Shkalla e notimit:</b> Notat përfundimtare të caktuara për këtë kurs do të bazohen në përqindjen e pikëve totale të fituara dhe do të përcaktohen si më poshtë: 100-95 %=10 94-85%=9 84-75%=8 74-65%=7 64-51%=6 0-50%=Nuk kalon</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 33%;">Nota me shkronjë</th> <th style="width: 33%;">Përqindja</th> <th style="width: 33%;">Performanca</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A=10</td> <td>95-100%</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> </tbody> </table>		Nota me shkronjë	Përqindja	Performanca	A=10	95-100%	Shkëlqyeshëm
Nota me shkronjë	Përqindja	Performanca						
A=10	95-100%	Shkëlqyeshëm						

B=9	85-94%	Shumë mirë
C=8	75-84%	Mirë
D=7	65-74%	Relativisht mirë
E=6	51-64%	Mjaftueshëm
F=5	0-50%	Dështim

**Stili i referencës dhe shkrimit:**  
 Studentët inkurajohen të përdorin stilin akademik gjatë hartimit të detyrave të kurseve dhe në rast të përdorimit të burimeve të tjera ata duhet të zbatojnë rregullat e APA-së.

**Literatura**

<b>Literatura bazë [A]</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• David Langlet &amp; Said Mahmoudi, <i>EU Environmental Law and Policy</i>. Oxford: Oxford University Press, 2016.</li> <li>• Patricia Park, <i>International Law for Energy and the Environment</i>. CRC Press, 2013.</li> <li>• Malgosia Fitzmaurice, <i>Contemporary Issues in International Environmental Law</i>. Edward Elgar Publishing Limited, 2009.</li> <li>• Material i përgatitur nga ligjëruesi për studentët.</li> </ul>
----------------------------	---

<b>Literatura shtesë [B]:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Efstathios E. Michaelides, <i>Energy, the Environment, and Sustainability</i>. CRC Press, 2018.</li> <li>2. Kim Talus, <i>Introduction to EU Energy Law</i>. Oxford: Oxford University Press, 2016.</li> <li>3. Roda Verheyen, <i>Climate Change Damage and International Law</i>. Boston: Martinus Nijhoff Publishers, 2005.</li> <li>4. Nico Schrijver &amp; Friedl Weiss, <i>International Law and Sustainable Development: Principles and Practice</i>. Brill: Martin Nijhoff Publishers, 2004.</li> <li>5. Ved P. Nanda &amp; George R. Pring, <i>International Environmental Law and Policy for the 21st Century</i>. Martin Nijhoff Publishers, 2013.</li> <li>6. Rosemary Lyster &amp; Adrian Bradbrook, <i>Energy Law and the Environment</i>. Cambridge University Press, 2006.</li> <li>7. Zejnullah Gruda, <i>E Drejta Ndërkombëtare Publike</i> [pjesa e 8-të], Universiteti i Prishtinës, 2009.</li> <li>8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008).</li> <li>9. Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.</li> <li>10. Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) 2013-2022 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.</li> <li>11. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës: 2017-2026.</li> </ol>
-------------------------------	---

**ORARI JAVOR I KURSIT**

Java	Ora / Dita	TEMA	[A] / Literatura bazë [B] / Literatura shtesë	DSH
1		HYRJE: PËRMBAJTJA E LËNDËS, METODA E VLERËSIMIT DHE METODAT E STUDIMIT		

2		<b>HYRJE NË TË DREJTËN PËR MJEDIS: HISTORIA DHE ZHVILLIMI</b>	
3		<b>BURIMET E TË DREJTËS SË MJEDISIT</b> [Kuizi 1]	
4		<b>E DREJTA DHE POLITIKAT MJEDISORE TË UNIONIT EVROPIAN</b>	
5		<b>E DREJTA E MJEDISIT NË VEPRIM</b> [Kuizi 2]	
6		<b>ROLI I KOMBEVE TË BASHKUARA NË ZHVILLIMIN E POLITIKAVE DHE TË DREJTËS SË MJEDISIT</b>	
7		<b>PROVIMI MES-SEMESTRAL</b>	
8		<b>ROLI I ORGANIZATAVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE NË ZHVILLIMIN E POLITIKAVE DHE TË DREJTËS SË MJEDISIT</b>	-Agjencitë e specializuara -Organizatrat rajonale ndër-qeveritare -Organizatrat joqeveritare
9		<b>E DREJTA PËR NJË MJEDIS TË SHËNDETSHËM: NDOTJA E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE GLOBALE</b> [Kuizi 3]	
10		<b>MBROJTJA E MJEDISIT DHE TREGTIA NDËRKOMBËTARE</b>	
11		<b>MJEDISI DHE ZHVILLIMI NJERËZOR: E DREJTA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM</b> [Kuizi 4]	
12		<b>MJEDISI, ENERGJIA DHE E DREJTA E BRENDSHME [E REPUBLIKËS SË KOSOVËS]</b> [Prezantimi në klasë 1]	

13		<b>MBETURINAT E RREZIKSHME, KIMIKATET DHE TEKNOLOGJIA MJEDISORE &amp; ENERGJETIKE</b> <b>[Prezantimi në klasë 2]</b>		
14		<b>ZHVILLIME BASHKËKOHORE NDËRKOMBËTARE: NDOTJA MJEDISORE NGA ANIJET DHE PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN</b> <b>[Përgatitje për provimin përfundimtar]</b>		
15		<b>PROVIMI PËRFUNDIMTAR</b>		

#### **POLITIKA AKADEMIKE DHE MIRËSJELLJA E STUDENTËVE:**

**Integriteti akademik.** Të gjithë studentët pritet të jenë etik në sjelljen e tyre. Ndërsa bashkëpunimi midis studentëve është i inkurajuar, detyrat e shtëpisë duhet të jenë origjinale dhe të punuara nga secili nxënës.

**Detyrat e shtëpisë** që i ngjajnë detyrave të një studenti tjetër do të kthehen me një rezultat zero.

- Detyrat e shtëpisë me vonesë **NUK** do të pranohen

**Provimi.** Ju mund të sillni laps dhe letër. Nuk lejohet të flitet gjatë periudhave të provimeve.

- "Puna në grup" në provim do të konsiderohet si mashtrim.
- Çdo sjellje mashtrimi do të çojë në notën (F = 5)
- Telefonat celularë duhet të çkyqen.
- Aplikacionet për llogaritje në telefona celularë nuk lejohen.

**Pjesëmarrja në orë:** Pjesëmarrja në orë është e obligueshme. Do të jetë e vështirë të kaloni nëse nuk jeni të rregullt. Ju mund të largoheni nga ky kurs pa njoftim pas dy mungesave të paarsyeshme.

**Akomodimi i nevojave të veçanta.** Studentët me nevoja të veçanta që kërkojnë akomodim për të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet e kursit, kërkohet të kontaktojnë mësimdhënësin gjatë javës së parë të semestrit.

**Konfliktet.** Nëse keni ndonjë konflikt me një nga provimet e planifikuara, kontaktoni Profesorin e lëndës sa më shpejt që të jetë e mundur. Sa më herët të njoftoni për një konflikt të mundshëm, aq më e madhe është përpjekja për të akomoduar konfliktin.

**Të gjitha detyrat me shkrim do të shikohen për plagjiaturë nga faqet e internetit, tekstet shkollore, projektet e mëparshme të klasës dhe artikuj të revistave.**